

VENDIM
Nr. 112, datë 15.2.2012

PËR HEQJEN NGA FONDI KULLOSOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES NË NGASTRËN NR. 37, TË EKONOMISË KULLOSORE “VLLAHAT-DHROVIAN”, DELVINË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “DINAMIKA”, SHPK PËR KARIERË GURI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga Fondi Kullor Kombëtar dhe çregjistrimin nga zëri kadastral “Kullotë”, të sipërfaqes prej 10 (dhjetë) ha, sipas të dhënave të përcaktuara në lejen minerare nr. 1369, datë 22.6.2009, lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila ndodhet në ngastrën nr. 37 të ekonominë kullorë “Vllahat-Dhrovian”, Delvinë, dhe që do të përdoret nga subjekti “Dinamika”, sh.p.k., për karrierë guri.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të Fondit Kullor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë për veprimtari minerare”, në zbatim të vendimit nr. 1374, datë 10.10.2008 të Këshillit Ministrave “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

3. Vlera e sipërfaqes kullorë të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga subjekti “Dinamika”, sh.p.k., në bazë të lidhjes nr. 4 të vendimit nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave””.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, subjekti “Dinamika”, sh.p.k., brenda 2 (dy) viteve, me fondet e veta, të përmirësojë 10 (dhjetë) ha kullota, në ngastrat e përcaktuara nga komuna Mesopotam dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Delvinë. Mënyra e përmirësimit deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së përmirësuar të bëhet sipas marrëveshjes, që do të lidhet ndërmjet palëve me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Mesopotam për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha